



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 58, datë 28.02.2023

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.1, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETË E TETË MILION E TREQIND E DYZETË E DYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHETITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”, I NDRYSHUAR

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023, “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetë e tetë milion e treqind e dyzetë e dymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shetitores së plazhit Durrës, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës”, i ndryshuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 31.01.2023 dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 13.01.2023, “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetë e tetë milion e


treqind e dyzetë e dymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shetitores së Plazhit Durrës, nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kovalishencës”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a. Ndryshimin e vlerës së shpronësimit, e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 31.01.2023, e cila bëhet 26570000 (njetzetë e gjashtëmilion e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për shkak të ndryshimeve të ardhura nga përditësimi i tre pasurive, si më poshtë:
 - b. Pasurinë me nr. 5/58, ZK 8514 ka rezultuar se është me gjendje juridike shtet.
 - c. Ndryshimin e vlerës së shpronësimit për pasurinë me nr. 27/357, ZK 8518, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 31.01.2023, e cila bëhet 2600000 (dymilion e gjashtëqind mijë) lekë, pasi është provuar, sipas kartelës së pronësisë, se kjo pasuri preket nga projekti për sipërfaqen 130 m².
 - d. Ndryshimin e vlerës së shpronësimit për pasurinë me nr. 27/317, ZK 8518, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 31.01.2023, e cila bëhet 2166000 (dymilion e njëqindegjashtëdhjetëgjashtëmijë) lekë, pasi është provuar, sipas kartelës së pronësisë, se kjo pasuri preket nga projekti për sipërfaqen 108.3 m².
 - e. Zëvendësimin e tabelës që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 31.01.2023, me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e këtij vendimi.
2. Ky vendim është pjesë e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 13.01.2023 dhe nr. 20, datë 31.01.2023.
3. Ngarkohet Drejtoria Ligjore (Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 166 prot.
114

Durrës, më 13.03 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 58 datë 28.02.2023 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.1, datë 13.01.2023, “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej 48342000 (dyzetë e tetë milion e treqind e dyzetë e dymijë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: “Projekt zbatimi për ndërtimin e shetitores së plazhit Durrës, nga ura e dajlanit deri në godinën e kovalishencës”, i ndryshuar.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

